



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.349/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), Anr.349/2025 e datës 04.02.2025,
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3, 000.00 (tremijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), ku pretendohet se më datë 03 Shkurt 2025, në ora 13:00, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur tubim në qytetin e Gjilanit, përkatësisht në sheshin Nuhi Berisha dhe Rexhep Shala, në qendër të qytetit, ku monitoruesit e KDI-së, kanë identifikuar pjesëmarrje të fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, në videon e dërguar nga monitoruesit e KDI-së ku vërehet prania e fëmijëve të mitur nën moshën 15 vjeçare, një veprimi i tillë bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, Më tutje në ankesë pretendohet se janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar të përcaktuara me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024. Andaj konsiderojnë se pamjet e tilla të shfaqura në video, ku prezenca e fëmijëve është evidente dhe kundërligjore, dhe se të njëjtit nuk do duhej tu lejohej qëndrimi në tubimin e organizuar nga subjekti LVV.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur Provë: CD e xhirimit ku shfaqen pamjet e fëmijëve nën moshën 15 vjeç.

PZAP me datë 04.02.2024 iu drejtua për përgjigje në ankesë subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje deri me datën 04.02.2025 në ora 18:30. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje e kundërshton ankesën me arsyetimin se e njëjta nuk përmban asnjë fakt i cili konsiderohet si shkelje e nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Në përgjigjen në ankesë thekson se siç vërehet në CD e bashkangjitur si provë të pretenduesit, nuk është e ndërlidhur me angazhimin e fëmijëve në fushatë rrjedhimisht nuk ka angazhuar fëmije në fushatë. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar se parashtruesi i ankesës nuk e ka argumentuar në asnjë moment pretendimin se “...vërehet prania e një fëmije të mitur, nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, pa prezencën dhe rrjedhimisht pa pëlqimin e prindërve”, siç vërehet edhe në videon e ngjarjes fëmija është në prezencën e prindërve. Andaj tubimi elektorale i mbajtur në Sheshin përkatës në qendër të Gjilanit është në përputhje të plotë me rregullat Zgjedhore, përkatësisht me nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar si dhe me legjislacionin në fuqi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli ka gjetur se nga video e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik LVV, përkatësisht gjatë fushatës zgjedhore në tubimin e tyre kanë përfshirë edhe fëmijë, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se *"Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore"*.

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik LVV, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, por për Panelin këto pretendime ishin të pabazuara nga se nga video e ofruara si dëshmi nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI, shihet se në tubimin elektorale të mbajtur në qytetin e Gjilanit shihet qartë pjesëmarrja e fëmijëve nën moshën 15 vjeç, gjatë fushatës zgjedhore për përfitime të votave për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, fëmijët si grup, dhe nuk vëreht se janë në përcjelljen e prindërve.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Kështu qe duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.349/2025 datë 06.02.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.